



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 60 datë 10.06 2026

**PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE TË AKTIVITETEVE SPORTIVE PËR VITIN
2026 TË SHOQATËS "KLUBI I FUTBOLLIT PËRMET"**

Bazuar në Ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 9, neni 25 pika 4, i ndryshuar; Ligjit 79/2017 «Për Sportin» neni 21; VKB Nr.113 datë 17.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Përmet për vitin 2026"; Ligji 8788 datë 07.05.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse"; Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin", Ligjin 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligji nr. 80/2021, "Për rregjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse", i ndryshuar me Ligji Nr.90 /2025; Vendim Nr.7707 datë 05.03.2026 i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë "Për themelimin e shoqatës "Klubi i Futbollit Përmet"; Kërkesa Nr.1938 Datë 02.06.2026 e Shoqatës Klubi Futbollit Përmet; Këshilli i Bashkisë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

VENDOSI:

1. Të miratojë mbështetjen financiare për aktivitetet sportive të shoqatës "Klubi Futbollit Përmet" për vitin 2026 në vlerën 2 000 000 lekë sipas kërkesave buxhetore të paraqitura nga shoqata me Kërkesë Nr.1938 Datë 02.06.2026.
2. Mbështetja për realizimin e aktiviteteve do të jetë sipas planifikimeve buxhetore në buxhetin e Bashkisë Përmet viti 2026, struktura buxhetore: AD135.V813AAB.604.Kap05.
3. Shpenzimet për aktivitetet e shoqatës do të mbulohen nga data e themelimit të saj me Vendim Gjykatë.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përfshirjes Sociale, Arsimit, Kulturë, Sport dhe Drejtoria e Buxhet Financës.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", (i ndryshuar).

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Aleks TANE

KRYETAR
Anila DHIMITRI